

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i Ndryshuar.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/619>, për 20 ditë pune nga data 28.03.2023 deri në datën 25.04.2023.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e konsultimit e përdorur për këtë projektligj është nëpërmjet Regjistrin Elektronik, RENJK;

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në kuadër të hartimit të këtij projektligji nuk janë parashikuar që të zhvillohen takime publike, por përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) dhe afishimit të të dhënave të kontaktit të kordinatorit përkatës për konsultime publike, i është dhënë mundësia organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të fushës, shoqatave, përfaqësuesve të tjerë të publikut apo çdo individ të interesuar që të

kontribuojnë në hartimin e këtij projektligji duke paraqitur çdo koment, opinion, sygjërim, etj, që ato kanë.

Përgjatë kohës në të cilën diskutimet për konsultim për këtë projektligj kanë qenë të hapura, në faqen e Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) apo edhe në adresën zyrtare elektronike të kordinatorit përkatës për konsultime publike të këtij projektligji, nuk ka ardhur asnjë reagim nga subjekte të interesuara.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
--	---	--	---	-------------

Shënim: komentet nga procesi i bashkërendimit me institucionet shtetërore janë reflektuar në relacionin shoqëruar.